



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Бр./Nr _____

_____г./в.



Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 12/2019) nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalim të Korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit të parashtruar nga parashtrues anonim, dorëzuar deri te, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në seancën e 50-të, të mbajtur më 22.07.2021, morri:

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-2638 / 1 e datës 10.08.2020 e formuar pas denoncimit të parashtruar nga parashtruesi ----- në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtëjshëm në lëndën me numër 12-2638 / 1 të datës 10.08.2020, për arsye se akuzat në të njejtën nuk konfirmohen.

Lënda me numër 12-2638/1 të datës 10.08.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-2638/1 të datës 10.08.2020 është formuar në bazë të denoncimit të parashtruar nga parashtruesi .

Në denoncim tregohen pohime për paligjshmëri dhe parregullsi në lidhje me shpalljen e konkurseve të bursave nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitet ----- dhe dhënien e bursave për studentët e ndërtimit nga kompani të panjohura në vitin 2018 , 2019 dhe 2020.

Me qëllim kontrollimin e pohimeve në denoncim dhe për të përcaktuar situatën faktike në rastin konkret, KSHPK me Kërkesë për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit me numër 12-1087 / 1 të datës 09.03.2021 kërkoi nga Rektori i Universitetit ---- - - - - të dorëzoj informacion të plotë nëse në tre vitet e fundit, 2018, 2019 dhe 2020, janë shpallur konkurse për bursa për studentët e regjistruar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitet ----- , nëse është kryer procedura e grumbullimit të aplikacioneve të kandidatëve të interesuar, nëse është formuar komision për të kryer procedurën pas konkurseve të shpallura dhe nëse është bërë përzgjedhje, renditja e kandidatëve të aplikuar në konkurs, të dorëzohet kopje e të gjithë dokumentacionit (vendimet, procesverbalet, etj.), dhe të theksohet burimi nga janë siguruar fondet (emri i kompanisë, detajet e themeluesit / menaxherit), të tregohet shuma totale e fondeve të ofruara për këtë qëllim, si dhe të dorëzohet listë të personave të zgjedhur si mbajtës të bursave (emri dhe mbiemri dhe shuma mujore e bursës dhe shuma totale e paguar për person), si dhe të dhëna të tjera përkatëse për procedurat e përmendura të kryera pas konkurseve të shpallura.

Një përgjigje u dorëzua nga Rektori i Universitetit brenda afatit të përcaktuar ligjërisht -----.

Gjatë shqyrtimit të rastit të lëndës, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit i morri parasysh pohimet në fjalë dhe pas kontrolleve të kryera në dokumentacionin e dorëzuar e përcakttoi si më poshtë:

Gjatë vitit 2019 dhe 2020, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin ----- nuk shpalli konkurs për dhënie e bursave për studentët.

Bazuar në situatën faktike të vërtetuar, KSHPK -ja arrin në përfundimin se në rastin konkret pohimet në lëndë nuk ishin konfirmuar, kështu që KSHPK -ja arriti në përfundimin se nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtejshëm në këtë rast dhe rasti të mbyllet dhe arkivohet.

Duke pasur parasysh të theksuaren e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së

Punoi:

Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

